



Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Shpallje për program të praktikës profesionale për studentë

1. Rrethanat Organizative

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) është themeluar me Ligjin Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë (LEE) si entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, në mbështetje të objektivave të politikës për Eficiencë të Energjisë së Republikës së Kosovës. FKEE promovon, mbështet dhe zbaton masat e eficiencës së energjisë, si dhe duke tërhequr dhe menaxhuar burimet financiare në mënyrë që të financojë dhe zbatojë projekte investimesh në fushën e Eficiencës së Energjisë në një mënyrë të qëndrueshme. FKEE shërben si institucioni kryesor financiar për këtë sektor.

2. Qëllimi dhe kohëzgjatja

Programi i praktikës profesionale për studentë i ofruar nga FKEE-ja mundëson lidhjen midis njohurive teorike të fituara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionin tonë.

Gjatë kohëzgjatjes së programit, praktikantët do të angazhohen në sektorë të ndryshëm të FKEE, me theks në asistimin aktiviteteve që lidhen me zbatimin e programeve të eficiencës së energjisë në sektorin rezidencial, përkatësisht atë të banimit.

Gjatë punës praktike studentet e përzgjedhur do të vendosen në objektin e institucionit tonë, në zyra rajonale (nëse disponohen) apo terren, nën udhëzimet e mbikëqyrësve të njësive përkatëse. Detyrat kryesore do të jenë asistimi i aplikuesve për masat e eficiencës në shtëpi banimi, asistence teknike apo këshilla praktike dhe informimi lidhur me programet e FKEE.

Ky program zgjatë deri në dymbëdhjetë (12) javë, varësisht nga nevoja, dhe nuk nënkupton marrëdhënie formale pune me FKEE-në.

Në fund të praktikës, studentët do të pajisen me certifikata për kryerjen e programit në fjalë.

FKEE ruan të drejtën e shpërblimit të secilit praktikant të përzgjedhur, bazuar në mundësitë buxhetore të ndara për qëllime të edukimit dhe ngritjes së kapaciteteve. Një shpërblim i tillë do të jetë i njësojtë për të gjithë dhe përcaktohet me rastin e lidhjes së kontratës së praktikës.

3. Kriteret për kualifikim:

Kriteret për përzgjedhje të studenteve për punë praktike në Fondin për Eficiencë të Energjisë janë si më poshtë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë studentë në vitin e fundit të studimeve universitare, në drejtimet si inxhinieri elektrike/mekanike, ndërtimtari, arkitekturë dhe fusha të ngjashme;
- Të kenë aftësi për të punuar në grup, individualisht si dhe në terren;
- Të kenë njohuri shumë të mira të kompjuterit në programet e MS Office dhe Internet (me dëshmi përkatëse).
- Përparësi kanë kandidatët me notë mesatare të studimeve mbi 8 (ose ekuivalent nëse notat shprehen me njësi tjetër matëse);

4. Të gjithë studentët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Kopja e letërnjoftimit apo ndonjë dokumentit tjetër identifikues valid.
- CV të detajuar (rekomandohet formati Europass);
- Letrën motivuese ku theksohet interesimi për program praktike dhe se si ndërlidhen studimet me aktivitetin e FKEE;
- Lista/Certifikata e notave nga universiteti/fakulteti përkatës, jo më e vjetër se 3 (tre) muaj (listën e notave të gjitha semestrave të përfunduar deri në momentin e aplikimit);
- Një letër referencë nga një pedagog/profesor nga universiteti/fakulteti përkatës apo rekomandim nga universiteti/fakulteti;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është 16 korrik 2023.
- Aplikimi mund të bëhet përmes postës elektronike në info@fkee-rks.net
- Dokumentacionet e pakompletuara siç janë përcaktuar në piken 4, nuk do të merren parasysh.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjedhja do të behet nga lista e kandidateve që plotësojnë kushtet nga pika 3, bazuar në dy seksione:

- Vlerësimin e CV dhe letrës motivuese
- Intervistën verbale

Vetëm studentet që plotësojnë kushtet do të kontaktohen për intervistë.